



Prishtinë, 14 tetor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1180_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 1699/3 dhe 1699/6, ZK Preoce, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** në Komunën e Graçanicës, të datës 09.09.2019 me nr. prot. 476/2019 të aplikuesit "OBRICO" SH.P.K., me adresë: "Magjistralja Prishtinë - Shkup", Komuna Graçanicës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 14 tetor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "OBRICO" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 1699/3 dhe 1699/6, ZK Preoce, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Graçanicës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "OBRICO" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9021305 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "OBRICO" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m




- ZRRE, me datë 09.09.2019 nga aplikuesi "OBRICO" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrale katastrale Nr. 1699/3 dhe 1699/6, ZK Preoce, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, shifra e konsumatorit DFE-9021305 në Komunën e Graçanicës.
 - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluar, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 5944 të datës 05.09.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 111436/19 të datës 23.08.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Graçanicës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "OBRICO" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e objektit të ndërtuar në parcelën ngastrale kadastrale Nr. 1699/3 dhe 1699/6, ZK Preoce, me kapacitet të instaluar prej **30 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së